



**REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT**  
**AGJENCIA E SHËRBIMEVE MEDIATIKE AUDIO DHE AUDIOVIZUELE**

**PA1 Nr.08-211**

**17.07.2026**

**Shkup**

Në bazë të nenit 18, paragrafi (1), nënparagrafi 20, neni 23, paragrafi (1), nënparagrafi 4 dhe neni 85, paragrafi (1), nënparagrafi 2 dhe paragrafi (2) të Ligjit të Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuele ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr.184/13, 13/14, 44/14, 101/14, 132/14, 142/16, 132/17, 168/18, 248/18 dhe 27/19 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr.42/20, 77/21, 154/23, 55/24, 193/24 dhe 247/25), në pajtim me nenin 10, paragrafi (5) të Rregullores së Punës së Agjencisë së Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuele, nr.ark.01-3632/1 të datës 22.08.2025, Kërkesën për lëshimin (dhënien) e aktvendimit për fshirje nga regjistri i radiodifuzerëve, dorëzuar nga avokati, autorizuesi i Shoqërisë për veprimtari radiodifuzive, tregti dhe shërbime EKO RADIO ShPKNjP Probishtip, nr ynë.ark.03-2718/1 të datës 9.7.2026, Deklaratën për ndërprerjen me transmetim të programit në radio nga themeluesi/pronari dhe drejtuesi i vetëm i transmetuesit, nr ynë.ark.03-2718/2 të datës 10.7.2026 (nr.UZP 2583/2026 të datës 10.7.2026) dhe Konkluzionin nr.ark.02-2771/3 të datës 16.7.2026, Këshilli i Agjencisë së Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuele, gjatë seancës së 26-të të mbajtur më 16.7.2026, miratoi:

**AKTVENDIM**

**për fshirje nga regjistri i radiodifuzerëve**

1. Shoqëria për veprimtari radiodifuzive, tregti dhe shërbime EKO RADIO ShPKNjP Probishtip FSHIHET nga regjistri i radiodifuzerëve.
2. Ky aktvendim botohet në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut" dhe në faqen e internetit të Agjencisë.
3. Ky aktvendim hyn në fuqi menjëherë.

**A r s y e t i m**

Shoqëria për veprimtari radiodifuzive, tregti dhe shërbime EKO RADIO ShPKNjP Probishtip (EKO RADIO Probishtip), është posedues i lejes për transmetim në radio, PA1 nr.08-120 të datës 7.9.2023 (me periudhë vlefshmërie nga data 5.1.2024 deri më 4.1.2027), i cili transmeton program përmes transmetuesi tokësor (Probishtip Kala, 88.8 MHz) në nivel lokal, në zonën e Komunës së Probishtipit, shërbim programor radio folëse-muzikore me format të përgjithshëm, në gjuhën maqedonase.

Avokati Katerina Makreska Petkovska, si autorizues i EKO RADIO Probishtip, në mënyrë elektronike, me datë 8.7.2026 në e-mail adresën oficiale ([contact@avmu.mk](mailto:contact@avmu.mk)) të Agjencisë së Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuele (AshMA-së) ka dorëzuar Kërkesë për dhënien e aktvendimit për fshirjen e EKO RADIO Probishtip nga regjistri i radiodifuzerëve (nr ynë.ark.03-2718/1 i datës 9.7.2026), ku thuhet se e njëjta është e nevojshme për procedurë likuidimi.

Bazuar në sa më sipër, nga ana e avokatit, autorizuesit të radiodifuzerit në fjalë, në mënyrë elektronike, drejtuar AShMA-së u dorëzua Deklaratë nga themeluesi/pronari dhe drejtuesi i vetëm i EKO RADIO Probishtip – Darko Panovski (e noterizuar) nr ynë.ark.03-2718/2 të datës 10.7.2026 (nr. UZP 2583/2026 të datës 10.7.2026), se radiodifuzeri nga data 06.07.2026 ndalon me transmetim të programit në radio.

Në pajtim me nenin 85, paragrafi (1), nënparagrafi 2 të Ligjit të Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuele (LSHMAAV), leja për transmetim në radio ndalon së vlefshmi sipas fuqisë ligjore me deklaram me shkrim të poseduesit me të cilën njofton Agjencinë se ndalon me transmetim të programit në radio. Për ndalimin e vlefshmërisë së lejes për transmetim në radio sipas fuqisë ligjore Këshilli nuk merr vendim. Agjencia do të fshijë transmetuesin nga regjistri i radiodifuzerëve nëse leja ndalon së vlefshmi sipas fuqisë ligjore (neni 85 paragrafi 2 i LSHMAAV).

Rrjedhimisht nga sa më sipër, duke marrë parasysh nenin 85, paragrafi (1), nënparagrafi 2 dhe paragrafi (2) të LSHMAAV-së, me dorëzimin e deklaratës me shkrim të lartpërmendur, janë plotësuar kushtet ligjore për ndalimin e vlefshmërisë së lejes sipas fuqisë ligjore, sipas të cilës Agjencia do të fshijë transmetuesin EKO RADIO Probishtip, nga regjistri i radiodifuzerëve.

Në bazë të nenit 18, paragrafi (1), nënparagrafi 20, neni 23, paragrafi (1), nënparagrafi 4 dhe nenin 85, paragrafi (1), nënparagrafi 2 dhe paragrafi (2) të LSHMAAV, në pajtim me nenin 10, paragrafi (5) të Rregullores së Punës së Agjencisë së Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuele, Kërkesa për dhënien e aktvendimit për fshirjen nga regjistri i radiodifuzerëve, dorëzuar nga avokati i autorizuar i Shoqërisë për veprimtari radiodifuzive, tregti dhe shërbime EKO RADIO ShPKNJ P Probishtip, nr ynë.ark.03-2718/1 të datës 9.7.2026, Deklaratës për ndalimin me transmetim të programit në radio nga themeluesi/pronari dhe drejtuesi i radiodifuzerit, nr ynë.ark.03-2718/2 të datës 10.7.2026 (nr UZP 2583/2026 të datës 10.7.2026) dhe Konkluzionin nr. ark.02-2771/3 të datës 16.7.2026, është marrë aktvendim si në dispozitiv, i cili hyn në fuqi menjëherë.

**Agjencia për Shërbime Mediatike  
Audio dhe Audiovizuele  
Kryetari i Këshillit,  
mr. Sasho Stefanovski, d.v.**

**Këshillë juridike:** Kundër këtij aktvendimi mund të ngrihet padi, për iniciimin e kontestit administrativ pranë gjykatës kompetente. Padia për iniciimin e kontestit administrativ paraqitet në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit.